



## **VENDIMI dhe GJETJET**

**Data e miratimit: 11 nëntor 2015**

**Numri i lëndës: 2012-22**

**Desanka dhe Zoran Stanisic**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 11 nëntor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **PROCEDURA**

1. Ankesa është regjistruar me 20 dhjetor 2012.
2. Me 7 qershor 2013, Paneli vendosi ta njoftoj rreth ankesës shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it, duke e ftuar atë të paraqes vërejtje me shkrim për ankesën. Gjithashtu Paneli vendosi të shqyrtoj meritat e aplikacionit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij (në pajtim me rregullën 30 paragrafët 1 dhe 2 të rregullores së punës, më tutje si: RrP).
3. Vërejtjet e ShM-së janë pranuar me datën 15 gusht 2013, e pas kësaj ato i janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.

4. Me 6 shtator 2013, ankuesit dërguan vërejtjet e tyre shtesë, të cilat ju dërguan ShM-së për informim.
5. Në përgjigje të komenteve të ankuesve, ShM-ja ka paraqitur vërejtje shtesë me 4 shkurt 2014.
6. Ankuesit kanë komentuar rreth vërejtjeve të ShM-së me 20 shkurt 2014.
7. ShM-ja ka ofruar parashtresa shtesë me 25 gusht 2014.
8. Ankuesit kanë parashtruar komentet e tyre me 9 tetor 2014.
9. ShM-ja iu është përgjigjur komenteve të ankuesve me 20 janar 2015.

## **FAKTET**

### **I. RRETHANAT E LËNDËS**

#### **Procedurat e lëndës nr. 1989-5/2011 (kërcënimet)**

10. Ankuesit pohojnë se në mes të datës 26 qershor 2011 dhe 29 qershor 2011, kanë pranuar mbi 30 telefonata kërcënuese në telefonat e tyre të mobil. Këto telefonata thuhet se janë bërë disa herë nga numra të fshehtë, posaçërisht pas mesnatës. Thirrjet përfshinin kërcënime me jetë dhe ato ishin të drejtuara ndaj familjes së ankuesve. Ankuesit dyshonin në njëfarë S.P., një personalitet i lartë politik që jeton në Prishtinë, i cili i ka bërë këto telefonata. Ankuesit pohojnë se kërcënimet ishin bërë për t'i bërë ata të heshtin dhe t'i detyrojnë ata që të tërhiqen nga disa procedura gjyqësore ndaj disa individëve, përfshirë disa personalitete politike në Kosovë. Këto procedura kanë të bëjnë me lëndët e uzurpimit të pronës që i përkasin ankuesve, si dhe me një lëndë të rrëmbimit të një anëtari të familjes së ankuesve.
11. Ankuesit ndër të tjera raportuan rastin në EULEX dhe në Policinë e Kosovës me 7 korrik 2011, në Ministrinë e Brendshme të Serbisë dhe në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë me 8 korrik 2011.
12. Me 25 gusht dhe 8 shtator 2011, ankuesit kanë parashtruar shtojca në aktakuzën e tyre penale.
13. Me 29 shtator 2011, ankuesit janë njoftuar se të gjitha informatat që ata kishin paraqitur në Policinë e Kosovës në këtë rast ishin sjellë në vëmendjen e prokurorit publik komunal në Prishtinë, i cili ishte përgjegjës për të hetuar rastin. Në një datë të pacaktuar pas kësaj, ankuesit u informuan se kryeprokurori i prokurorisë publike komunale në Prishtinë kishte vendosur të ftojë prokurorët e EULEX për t'u marrë me lëndën.

14. Me 30 janar 2012, ankuesit ishin njoftuar se është vendosur që një ekip i përzier i prokurorëve, duke përfshirë një prokuror të EULEX-it dhe të Kosovës, do ta merr përsipër lëndën.
15. Me 27 mars 2012, një prokuror i EULEX-it ishte caktuar në ekipin e përzier të prokurorëve që punojnë në këtë rast, në bazë të marrëveshjes ndërmjet kryeprokurorit komunal dhe prokurorit të EULEX-it.
16. Me 11 maj 2012, në bazë të kërkesës së prokurorit të Serbisë, policia serbe (MUP-i) përmes zyrtarit ndërlidhës rajonal të EULEX-it ka dorëzuar dokumentet në lidhje me rastin tek kryeprokurori i EULEX-it për procedim të mëtejshëm.
17. Më 29 tetor 2012, prokurori i EULEX-it ka lëshuar autorizim për Policinë e Kosovës me një kërkesë për të identifikuar përdoruesit e numrit të telefonit nga i cili janë bërë telefonatat kërcënuese. Me 1 nëntor, ai ka marrë nga Policia e Kosovës një raport në lidhje me këtë. EULEX-i pohon se duke u bazuar në shkresat e lëndës të marra nga prokuroria vendore nuk ka të dhëna zanore apo transkript të bisedave telefonike.
18. Me 8 nëntor 2012, ankuesit kanë marrë nëpërmjet postës elektronike një njoftim zyrtar për hedhjen poshtë të kallëzimit penal nga prokurori i EULEX-it. Ata u informuan se ai kishte vendosur që mos ta realizoj ndjekjen penale në pajtim me nenin 208 par. 1 të KPPK-së (“nuk ka dyshim të arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën penale”). Ankuesit po ashtu ishin të informuara për të drejtën e tyre që të ndjekin më tutje lëndën si “ndjekje penale private”.
19. Me 16 nëntor 2012, ankuesit kanë paraqitur një aktakuzë private në gjykatën komunale të Prishtinës.

#### **Procedurat në lëndën nr. 3086-2/2011 (rrëmbimi dhe veprat e tjera)**

20. Më 13 qershor 2011, ankuesit kanë dorëzuar një kallëzim penal në prokurorinë publike komunale në Prishtinë. Akuzat kishin të bënin me veprat penale të shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, rrëmbimit (të ankuesit të parë), uzurpimit joligjor të pronës së paluajtshme dhe mashtrimit. Veprat e mësipërme pretendohet se ishin kryer më 1 korrik 1999.
21. Me 2 shkurt 2012, një prokuror i EULEX-it ishte caktuar në ekipin e përzier të EULEX-it dhe prokurorëve vendorë që e hetonin rastin, pas një marrëveshjeje midis kryeprokurorit komunal dhe EULEX-it.
22. Duke e hetuar rastin, ekipi i përzier i ka shqyrtuar dokumentet në lidhje me pretendimet e ngjashme të paraqitura më parë nga ankuesit tek institucioneve prokuroriale të UNMIK-ut. Prokurori i UNMIK-ut i ka hedhur poshtë ankesat lidhur me vjedhje dhe rrëmbim, me 15 shkurt 2007. Me 20 janar 2009, prokurori publik i qarkut në Prishtinë ka

hedhur poshtë kallëzimin penal në lidhje me akuzat e uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme, mashtrimit dhe shkeljes së statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, për shkak të parashkrimit të veprimeve prokuroriale. Në një datë të pasaktësuar, gjyqtari konfirmues i Gjykatës Komunale të Prishtinës ka hedhur poshtë akuzat për rrëmbimin ndaj tre personave që është sjellë nga ankuesi i dytë që vepron si paditës dytësor, për shkak të parashkrimit. Me 22 shkurt 2011, Gjykata Komunale e Prishtinës ka refuzuar ankesën e ankuesit kundër atij vendimi.

23. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, ekipi i përzier i prokurorëve konkludoj se nuk kishte asnjë dyshim të arsyeshëm se një person i identifikueshëm ka kryer veprat penale në këtë çështje dhe se hetimet e mëtejshme nga ana e policisë nuk do të japin ndonjë informacion tjetër. Ata gjithashtu morën parasysh parashkrimet dhe parimin *ne bis idem* atëherë kur u vendos që mos të çohet çështja përpara.
24. Me 5 nëntor 2012, ankuesit kanë marrë nëpërmjet postës elektronike një njoftim zyrtar rreth refuzimit të kallëzimit penal nga prokurori i EULEX-it. Ato u informuan se ai kishte vendosur që mos ta vazhdojnë ndjekjen penale në përputhje me nenin 208 par. 1 të KPPK-së ("dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën penale"). Ankuesit gjithashtu ishin informuar për të drejtën e tyre për të ndjekur më tej çështjen si "ndjekjen penale".

#### **Procedurat në lëndën nr. 3985-8/2011 (Falsifikimi i dokumenteve dhe vepra të tjera)**

25. Me 6 shtator 2011, ankuesja ka dorëzuar një kallëzim penal në prokurorinë publike komunale në Prishtinë. Pretendimet e tyre kishin të bënin me falsifikimin e dokumenteve, përfshirë dokumentet zyrtare, duke shkelur statusin e barabartë të banorëve të Kosovës, legalizim të përmbajtjes së pavërtetë: Ankuesit pohuan se persona të paidentifikuar qëllimisht kishte fshehur një dosje të lëndës në lidhje me procedurat civile ku ata ishin përfshirë.
26. Me 27 mars 2012, një prokuror i EULEX-it ishte caktuar në një ekip të përzier të prokurorëve vendorë dhe të EULEX-it për të punuar në këtë rast.
27. Ekipi i prokurorëve konkluduan se ishte e qartë se nuk kishte asnjë dyshim të arsyeshëm se personi konkret kishte kryer veprat e supozuara penale dhe që hetime të mëtejshme nga ana e policisë nuk do të japin ndonjë informacion të mjaftueshëm.
28. Me 5 nëntor 2012, ankuesit kanë marrë nëpërmjet postës elektronike një njoftim zyrtar rreth refuzimit të kallëzimit penal nga prokurori i EULEX-it. Ata u informuan se ai kishte vendosur që mos ta vazhdonte ndjekjen penale në pajtim me nenin 208 par. 1 të KPPK-së ("dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën penale"). Ankuesit

gjithashtu janë informuar për të drejtën e tyre për të vazhduar më tej çështjen si “ndjekje penale private”.

## II. ANKESAT

29. Në thelb ankuesit pohojnë se prokurorët e EULEX-it si dhe prokurori vendor kanë abuzuar pozitat e tyre apo ka vepruar në mënyrë të pakujdesshme dhe diskriminuese ndaj tyre. Ankuesit pohojnë se ata kanë marrë kërcënime shumë serioze ndaj jetës së tyre nga zyrtarë të lartë të qeverisë së Kosovës dhe ishin të privuar nga pronat e tyre dhe se prokurorët e EULEX-it ka dështuar të hetonin siç duhej krimet ndaj tyre.
30. Paneli do të shqyrtoj parashtrirat e ankuesve sipas neneve 3 (ndalimi i torturës), nenit 8 (e drejta për jetë private), nenit 13 (e drejta për ankim efektiv) dhe nenit 14 (jo-diskriminim) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut (Konventa).

## III. LIGJI I ZBATUESHËM PËRKATËS

### Veprimi i përbashkët

31. Neni 2 dhe 3 i Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 lidhur me Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË (më tutje: Veprimi i Përbashkët), për pjesët e tyre përkatëse, thotë si në vijim:

#### **Neni 2 Deklarata e Misionit**

EULEX-i KOSOVË do t'i ndihmoj institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin ligjit në përparimin e tyre drejt stabilitetit dhe besueshmërisë në zhvillimet e mëtejshme dhe forcimin e sistemit të pavarur shumetnik të drejtësisë, të policisë, të doganës duke siguruar që këto institucione nuk do të ndikohen politikisht dhe do t'ju përmbahen standardeve të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane.

EULEX-i KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me programet për asistencë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij nëpërmjet monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke mbajtur edhe disa përgjegjësi ekzekutive.

#### **Neni 3 Detyrat**

Me qëllim të përmbushjes së Deklaratës së Misionit të përcaktuar në nenin 2, EULEX-i KOSOVË do të:

(a) monitoroj, udhëzoj dhe këshilloj institucionet kompetente kosovare në të gjitha sferat që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), ndërsa mbanë edhe disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;

...

(d) siguroj që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ndër-etnike, krimet financiare/ekonomike dhe të krimeve tjera serioze hetohen, ndiqen penalisht, gjykohen dhe zbatohen siç duhet në bazë të ligjit në fuqi, përfshirë aty ku është e nevojshme, edhe nga hetues, prokurorë dhe gjyqtarë ndërkombëtar, që punojnë bashkë me hetuesit,

prokurorët dhe gjyqtarët kosovarë apo në mënyrë të pavarur, dhe të merren masa, përfshirë edhe kur është e nevojshme, për krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe atyre për ndjekje penale;

(e) kontribuoj për fuqizimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit nëpër mbarë procesin juridik, sidomos në fushën e krimit të organizuar;

(f) kontribuoj në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar;

## Ligji mbi kompetencat

32. Ligji mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve gjyqarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (nr. 03/L-053, më tutje: Ligji mbi kompetencat) dhe më saktësisht nenet e tij 5, 7 dhe 8, e rregullojnë integrimin dhe kompetencat e gjyqarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

### **Neni 5 Kompetenca e gjyqarëve të EULEX-it për lëndët civile**

5.1 Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë civile do të kenë kompetencë që të përzgjedhin dhe marrin përgjegjësi, në pajtim me Kryetarin e Asamblesë së gjyqarëve të EULEX-it dhe në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqarëve të EULEX-it për:

...

c) çdo lëndë të re apo të pazgjidhur civile që ka të bëjë me pronën, përfshirë këtu ekzekutimin e procedurave që janë në juridiksion të cilësdo gjykatë në Kosovë, nëse:

(i) ekziston dyshimi i bazuar i përpjekjeve për të ndikuar në paanësinë apo pavarësinë e gjyqësorit vendor; apo

(ii) ekziston dyshimi i bazuar se gjyqësori vendor nuk është i gatshëm apo është i paaftë që ta shqyrtojë lëndën siç duhet; apo

(iii) ekziston dyshimi i bazuar në shkeljen serioze të zhvillimit të drejtë të procedurës.

### **Neni 7 Kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it**

7.1 Prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetenca dhe përgjegjësi që të ushtrojnë funksionet e tyre, përfshirë këtu kompetencat për të kryer hetime penale dhe për të marrë përgjegjësi për hetime penale apo procedura të lëndëve të reja dhe atyre të pazgjidhura në kuadër të PSRK-së apo në kuadër të zyrave prokuroriale ku ata janë caktuar nga kryeprokurori i EULEX-it dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji dhe nga Asambleja e prokurorëve të EULEX-it.

### **Neni 8 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në Kosovë**

8.1 Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetent për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të veçantë të PSRK-ës sipas ligjit mbi themelimin e PSRK-në, dhe krimet, përfshirë këtu tentimin dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krime, të paraqitura në të gjitha pikat e paragrafit 3 të nenit 3 të këtij ligji.

## LIGJI

33. Ankuesit pohojnë se veprimet e EULEX-it kanë shkelur nenet 3, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Në këto dispozita përderisa janë relevante thuhet:

### Neni 3 Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

### Neni 8 E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

...

### Neni 13 E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

### Neni 14 Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në arsye si: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çfarëdo statusi tjetër.

## Parashtrirat nga palët

34. Në parashtrimet e tij ShM-ja ka theksuar pozitën autonome të prokurorëve të EULEX-it, të garantuar me dispozitat përkatëse të Veprimit të Përbashkët të vitit 2008, OPLAN-it të EULEX-it dhe të Ligjit mbi kompetencat. Ai ka parashtruar se ky parim duhet gjithmonë të merren parasysh kur të vlerësohen veprimet e prokurorëve në lëndët që janë në Panel.
35. ShM-ja ka pohuar po ashtu se hetimet zyrtare ishin iniciuar në të gjitha rastet, për aq sa kanë lejuar parashtrimet dhe parimi *ne bis in idem*. Për sa i përket atyre pengesave, ShM-ja ka pohuar se EULEX-i nuk mund të mbahet përgjegjës për secilën të metë të perceptuar në procedurat fillestare të kryera nga UNMIK-u.
36. ShM-ja ka theksuar se hedhja poshtë e kallëzimeve penale të ankueseve nuk përbën ndërprerje të procedurës penale.
37. Duke komentuar mbi shkeljen e pretenduar të nenit 3 të Konventës, ShM-ja ka thënë se dëshmitë e paraqitura në rastin konkret nuk tregojnë se ankuesit ndonjëherë i janë nënshtuar keqtrajtimit që do të hynte në kuadër të kësaj dispozite. Sa i përket aspektit procedural të nenit 3, ShM-ja ka qenë i mendimit se EULEX-i ka respektuar të gjitha detyrimet e veta pozitive dhe procedurale për të hetuar pohimet e besueshme për shkeljet e të drejtave.
38. ShM-ja ka përsëritur të njëjtin arsyetim kur ka komentuar shkeljet e pohuara të nenit 8 të Konventës, duke argumentuar se nuk ka asnjë tregues se të drejtat e ankuesve sipas këtij neni janë shkelur. E as EULEX-i nuk i ka neglizhuar detyrimet e veta pozitive për të mbrojtur këto të drejta.

39. ShM-ja më tej pohoj se, sipas tij, nuk ngritët asnjë çështje sipas nenit 13 të Konventës.
40. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 14 të Konventës, ShM-ja ka pohuar se nuk është i nevojshme asnjë shqyrtim i veçantë, pasi që nuk është treguar se ankuesit i ishin nënshtruar ndonjë pabarazie në gëzimin e të drejtave të tyre themelore sipas neneve 3, 8 ose 13.
41. Në përgjigjen e tyre ndaj vërejtjeve të ShM-së, ankuesit në thelb kanë përsëritur parashtrimet e tyre fillestare. Ata pohuan se EULEX-i ka shkelur të drejtën e tyre për qasje në gjykatë përderisa janë marrë me lëndët e tyre.
42. Ankuesit kanë përsëritur pakënaqësinë e tyre në mënyrën se si prokurorët e EULEX-it kanë komunikuar me ta. Ata kanë parashtruar se ata ishin të privuar nga e drejta e tyre për të marrë një shpjegim rreth refuzimit të kallëzimeve të tyre penale dhe nuk ju ishte dhënë qasje në dosjen e lëndës, e cila i ka penguar ata nga ndjekja e procedurës penale si ndjekje dytësore penale. Ata thanë se ishin në disavantazh në krahasim me kundërshtarin e tyre, të dyshuarin, i cili është një politikan i profilit të lartë, dhe për këtë arsye ata pretendojnë se nuk ishte përfillur parimi i barazisë së palëve. Ata më tej parashtruan se parimi i barazisë do të shkelet kur autoriteti publik nuk arrin t'i siguroj informacion të plotë dhe me kohë personit që kërkon të garantohen ose të mbrohen të drejtat e tij.
43. Ankuesit theksuan se ata nuk e kanë kontestuar të drejtën e prokurorëve të EULEX-it për të vendosur, në pajtim me ligjin në fuqi, nëse një rast i caktuar duhet të hetohet apo jo. Ankesa e tyre lidhet me faktin se refuzimi nga EULEX-i i kallëzimit të tyre penal i ishte dërguar atyre përmes postës elektronike pa ndonjë shpjegim pse ishte marrë një vendim i tillë. Në veçanti, ata nuk ishin të informuar se çfarë hapash hetimorë ishin ndërmarrë. Prokurorët e EULEX-it asnjëherë nuk u takuan me ankuesit apo asnjëherë nuk shprehën një dëshirë të tillë.
44. Në përfundim, ankuesit deklaruan se nëse autoritetet nuk janë në gjendje që të parandalojnë trajtimin poshtërues ndaj një personi ose kërcënimet për jetën e tyre private dhe familjare, ata kanë detyrim pozitiv për të parashikuar dhe për të mundësuar mekanizma efektiv ligjor për identifikimin dhe dënimin e personave, përgjegjës për problemin e tillë. EULEX-i ishte kërkuar në këtë rast që të kryejë një hetim të plotë dhe të informoj ankuesit, si palë e dëmtuar, rreth të gjitha gjetjeve dhe për t'i përfshirë ata në hetim. Ata pohuan se kërcënimet që vinin nga një zyrtar i lartë qeveritar ka rezultuar me ndjenjë të fortë të cenueshmërisë, poshtërimit dhe të frikës. Për më tepër, që nga vera e vitit 1999 ankuesit kanë qenë të privuar nga e drejta e tyre në shtëpinë e tyre. Ata gjithashtu besonin se, si persona të zhvendosur brenda vendit që i përkasin pakicës serbe, ata në mënyrë të pabarabartë ishin të dëmtuar dhe se prokuroria e EULEX-it duhet të kishte vëmendje më të madhe për këtë fakt.



45. ShM-ja ka paraqitur vërejtje shtesë në përgjigje të komenteve të ankuesve. Ai ka pohuar se kuadri ligjor në fuqi nuk përmban asnjë detyrim që të ofrohet ndonjë vendim për refuzimin e kallëzimit penal me arsyetim specifik dhe të hollësishëm.
46. Për më tepër, edhe nëse njoftimet rreth refuzimit në ndonjërin prej rasteve kanë pasur të meta, sipas mendimit të ShM-së, ato nuk kanë rezultuar në shkeljen e të drejtave të njeriut. Ndryshe nga vendimet gjyqësore, vendimet e prokurorëve për të refuzuar një ankesë penale nuk kërkojnë që të ofrojnë arsyetim të hollësishëm nga ndonjë instrument përkatës i të drejtave të njeriut dhe parimeve të pasqyruara në to.
47. ShM-ja ka shtuar se ankuesve iu është dhënë qasje në të gjitha prej të tria shkresave të lëndës.
48. Ankuesit i janë përgjigjur vërejtjeve shtesë të ShM-së dhe kanë përsëritur komentet e tyre të mëparshme. Në veçanti, ata deklaruan se EULEX-i ka shkelur të drejtat e tyre themelore të njeriut, posaçërisht të drejtën e tyre për qasje në gjykatë.
49. ShM-ja iu është përgjigjur vërejtjeve të ankuesve dhe ka përmbledhur faktet dhe parashtrësat e bëra më parë. Ai ka përsëritur gjithashtu qëndrimin e tij se nuk ka asnjë detyrim ligjor për një prokuror që të informoj palën që supozohet se është e dëmtuar rreth veprimeve të kryera gjatë hetimeve paraprake.

### **Vlerësimi i Panelit**

#### *Mandati i Panelit (Rregulla 25 par. 1 i Rregullores së Punës)*

50. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet demokratike ligjore.
51. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do t'i pranojë ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të punës.

52. Nuk ka pasur ndonjë vërejtje nga palët sa i përket pranueshmërisë së ankesës.
53. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
54. Paneli tashmë ka vendosur se veprimet e prokurorëve dhe të policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih për shembull *Krlic kundër EULEX-it*, nr. 2012-21, 26 gusht 2014, § 23; *Y kundër EULEX-it*, nr. 2011-28, 15 nëntor 2012, § 35). Paneli nuk sheh ndonjë arsye këtu që të ketë shmangie nga kjo pikëpamje.

*Shkeljet e pretenduara të nenit 3 të Konventës*

55. Paneli konstaton se keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie në mënyrë që ajo të hyn brenda fushëveprimit të nenit 3 të Konventës. Vlerësimi i këtij niveli varet nga të gjitha rrethanat e rastit (shih për shembull *Irlanda kundër Mbretërisë Bashkuar*, 18 janar 1978, § 162, Seria A nr. 25).
56. Paneli nuk është e bindur se ankuesit kanë treguar se, me anë të veprimeve apo mosveprimeve të veta, EULEX-i i ka vënë ata në ndonjë trajtim të tillë që do të hynte brenda fushëveprimit të nenit 3.
57. Duke pasur parasysh këtë që u tha më sipër, Paneli konkludon se kjo ankesë është haptazi e pabazuar.

*Shkeljet e pretenduara të nenit 8 të Konventës (detyrimet pozitive)*

58. Paneli thekson se, sipas jurisprudencës së Gjykatës, nocioni i “jetës private” sipas nenit 8 është nocion i gjerë dhe nuk preket nga përkufizimi shterues; mundet që varësisht nga rrethanat të përfshijë integritetin moral dhe fizik të personit (shih *X dhe Y kundër Holandës*, aktgjykimi i datës 26 mars 1985, Seria A nr. 91, fq. 11, § 22; *Niemietz kundër Gjermanisë*, aktgjykimi i datës 16 dhjetor 1992, Seria A nr. 215-B, fq. 11, § 29; *Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 25 mars 1993, Seria A nr. 247-C, fq. 60-61, § § 34 dhe 36). Neni 8 gjithashtu mbron shtëpinë e një personi dhe disa aktivitete profesionale ose afariste apo lokalet (shih për shembull *Niemietz kundër Gjermanisë*, aktgjykimi i cituar më lartë, § 31).
59. Paneli thekson më tej se dështimi i autoriteteve për të mbrojtur integritetin fizik ose moral të një personi apo për të parandaluar sulmet në shtëpinë dhe pronën e tyre mund të ngritë çështjen sipas nenit 8 të Konventës në kuadër të detyrimeve të tyre pozitive obliguese në këtë dispozitë (*X dhe Y kundër Holandës*, 26 mars 1985, §§ 22-23, Seria A nr. 91; *Odièvre kundër Francës* [GC], nr. 42326/98,

§ 42, GjEDNj 2003-III; *Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 36022/97, §§ 96-98, GjEDNj 2003-VIII).

60. Megjithatë, Paneli nuk është i bindur se është vendosur që në këto rrethana veprimet e EULEX-it kanë marrë pjesë ose kontribuar në shkeljen e së drejtës së ankuesve sipas nenit 8 të Konventës. Përderisa neni 8 i të drejtave të ankuesve mund të jetë shkelur nga palët e treta, nuk është treguar se si veprimet ose mosveprimet e EULEX-it do të kishin qenë pjesë e një shkeljeje të tillë. Në veçanti, nuk është vendosur që EULEX-i ka inkurajuar apo ka mbetur i verbër ndaj këtyre ndërhyrjeve. Përkundrazi, në mënyrë pozitive ka kërkuar që të hetoj këtë çështje, megjithëse pa sukses. Përderisa ai hetim nuk mund të ketë qenë i përsosur, nuk është vërtetuar nga ankuesit se përfshirja e EULEX-it në këtë hetim ka kontribuar në shkeljen e nenit 8 të të drejtave të tij.
61. Paneli konkludon në përputhje me rrethanat se faktet e rastit nuk tregojnë ndonjë shkelje nga EULEX-i i të drejtave të garantuara me nenin 8 të Konventës.

#### Shkeljet e pretenduara të nenit 13 të Konventës

62. Paneli thekson se ekzistenca e shkeljes aktuale të një dispozite tjetër materiale të Konventës nuk është parakusht për zbatimin e këtij neni (shih *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë* aktgjykimi i datës 6 shtatorit 1978, Seria A nr. 28, fq. 29, § 64), me kusht që ankesat e tyre nën këto dispozita mund të konsiderohen të “diskutueshme” në kuptim të kësaj Konvente (shih për shembull *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 27 prill 1988, Seria A nr. 131, fq. 23, § 52, *Costello Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lartë, § 39). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është përmbajtur nga dhënia e një përkufizim abstrakt të nocionit “e diskutueshme”, duke preferuar që në secilin rast të përcaktohet në dritën e fakteve të caktuara dhe natyrën e çështjeve ligjore të ngritura, nëse një ankesë rreth një shkeljeje që përbën bazën për ankesë sipas nenit 13 është e diskutueshme dhe në qoftë se po nëse kërkesat e kësaj dispozite janë plotësuar në lidhje me to. Në dhënien e vlerësimit, Gjykata do të marrë në konsideratë rezultatet e tij mbi pranueshmërinë e ankesës materiale (shih *Ivan Atanasov kundër Bullgarisë*, nr. 12853/03, §§ 100-101, 2 dhjetor 2010, dhe *Boyle dhe Rice*, cituar më lartë, § 54). Megjithatë fakti se një pretendim substancial shpallet i papranueshme, jo domosdoshmërisht përjashtojnë rolin e nenit 13 (shih *I.M. kundër Francës*, nr. 9152/09, § 103, 2 shkurt 2012; *Gebremedhin [Gaberamadhien] kundër Francës*, nr. 25389/05, §§ 55 56, GjEDNj 2007 II, dhe *M.A. kundër Qipros*, nr. 41872/10, §§ 119-121, KEDNJ 2013; *Asalya kundër Turqisë*, nr. 43875/09, § 97, 15 prill 2014). Paneli e ka zbatuar këtë qasje për qëllimet e kësaj lënde.

63. Fusha e zbatimit të nenit 13 ndryshon varësisht nga natyra e ankesës së ankuesit. Megjithatë në çdo rast, mjeti që kërkohet nga neni 13 duhet të jetë “efektiv” në praktikë dhe po ashtu edhe në ligj (shih *Aksoy kundër Turqisë*, aktgjykimi i datës 18 dhjetor 1996, Reportet 1996-VI, fq. 2286, § 95; *Aydin kundër Turqisë* aktgjykimi i datës 25 shtator 1997, Raportet 1997-VI, fq. 1895-1896, § 103). Aty ku ka të bëjë me dështimin e pretenduar nga ana e autoriteteve për mbrojtjen e personave nga veprimet e të tjerëve, neni 13 nuk mund që gjithmonë të kërkojë që autoritetet të ndërmarrin përgjegjësinë për hetimin e akuzave (*D.P. dhe J.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 38719/97, § 135 10 tetor 2002). Megjithatë kur ekziston një mjet i tillë, ai duhet të jetë efektiv, pra i aftë që të ofroj dëmshpërblim dhe të ofroj mundësi të arsyeshme për sukses (*O’Keeffe kundër Irlandës* [GC], nr. 35810/09, § 177, KEDNj 2014).
64. Paneli thekson se EULEX-i ka kryen një hetim në secilin prej akuzave të ngritura nga ankuesit. Në atë masë, Misioni nuk mund të thuhet se e ka neglizhuar tërësisht hetimin e ndonjë aspekti të veçantë të rastit. Paneli gjithashtu thekson se prokurorët e EULEX-it kanë ndërmarrë hapa të ndryshme për të marrë informacionin e duhur - përfshirë duke kërkuar ndihmën e autoriteteve vendore dhe serbe. Gjithashtu janë ndërmarrë në mënyrë të rregullt hapa të tjerë hetimor. Për më tepër, Paneli nuk ka gjetur ndonjë tregues se ankuesit ishin të diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre etnike.
65. Megjithatë Paneli është i shqetësuar nga të metat e caktuara në procesin hetimor: mungesa e dukshme e përfshirjes së viktimave në procesin e hetimit; mungesa e një shpjegimi të arsyetuar për ndërprerjen e procedurës në këto raste.
66. Në bazë të konsideratave të ligjshme të konfidencialitetit dhe të sigurisë, viktimat në parim kanë të drejtë të jenë të përfshira sa duhet dhe të jenë të informuar rreth procesit të hetimit (shih në përgjithësi vendimin e Panelit në *L.O. kundër EULEX-it* nr. i lëndës 2014-32, 12 nëntor 2015, §§ 60-61; *Ahmet Özkan dhe të Tjerët kundër Turqisë*, cituar më lartë, §§ 311-314, 6 prill 2004; *Isayeva kundër Rusisë*, cituar më lartë, § 211-214; *Al-Skeini dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 55721/07, 7 korrik 2011 §167, GjEDNj 2011).
67. Për më tepër, nevoja se duhet të ofrohet në mnyrë të mjaftueshme ndonjë shpjegim i arsyetuar për mbylljen e hetimit, ofron një element të nevojshëm për shqyrtim dhe përgjegjësi publike (shih *I kundër EULEX-it*, lënda nr. 2013-01, vendimi i 27 nëntorit 2013, § 15). Në vitin 2005, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoj me konsensus një sërë “Parimesh Themelore dhe Udhëzime mbi të drejtën për mjet korrigjues dhe korrigjim për viktimat e shkeljeve të të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe shkeljeve serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar”. Sipas këtij instrumenti, detyrimi për të respektuar, për të siguruar respektimin dhe zbatimin e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe të drejtën humanitare ndërkombëtare, siç parashihet në organet përkatëse të ligjit, *ndër të tjera* përfshinë detyrën për të

“hetuar shkeljet në mënyrë efektive, të shpejtë, të plotë dhe në mënyrë të paanshme” (Parimet themelore, par 3 (b); shih gjithashtu, *ndër të tjera, Bouyid kundër Belgjikës*, aktgjykimi i datës 28 shtator 2015, §§ 114-123 dhe autoritetet e cituara, shih gjithashtu nenin 6 (1) dhe (3) dhe nenin 11 të Direktivës 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012, vendosjen e standardeve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe zëvendësimi i Vendimit Kornizë të Këshillit 2001/220/JHA). Verifikimi se një autoritet është në pajtueshmëri me këto elemente nga ana e tij kërkon ndonjë formë të shpjegimit për vendimin e tij për të mbyllur ose përfunduar një hetim qoftë mbi gjetjet e fakteve apo qoftë mbi dispozitat e së drejtës materiale të zbatuara (shih përsëri / *kundër EULEX-it*, lënda nr. 2013-01, vendimi i datës 27 nëntorit 2013, § 15). Një shpjegim i arsyetuar nga autoritetet është gjithashtu në përputhje me të drejtën e viktimave për t’u trajtuar me dinjitet dhe me të drejtën e tyre për të vërtetën.

68. Për më tepër, mungesa e shpjegimit të arsyetuar apo arsyeve jo të duhura të dhëna për përfundimin apo ndërprerjen e hetimeve mund të jetë e papajtueshme me mbrojtjen e të drejtave, në veçanti të drejtën e viktimës për zgjidhje efektive (shih p.sh. *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 4 maj 2001, në veçanti § 123; *Rodríguez kundër Uruguait*, Komunikata nr. 322/1988, UN Dok. CCPR/C/51/D/322/1988 (1994), § 6.3). Për shembull, kështu do të jetë që nëse e privon viktimën nga e drejta e tij për një zgjidhje efektive tjetër në dispozicion ose e privon atë në ndonjë rast konkret sa i përket përdorimit efektiv të këtij mjeti juridik.
69. Paneli thekson se edhe përfshirja e viktimave në procesin hetimor dhe nevoja për një shpjegim të arsyetuar të përfundimit të këtij procesi kanë për qëllim të krijojnë një shkallë të mjaftueshme të shqyrtimit publik dhe një ndjenjë në mesin e viktimave që ata janë trajtuar në mënyrë të drejtë dhe se kërkimi i tyre i drejtësisë është ndjekur me kujdes dhe në mënyrë efektive nga autoritetet (shih në përgjithësi *Angelova kundër Bullgarisë*, nr. 38361/97, § 140, GjEDNj 2002-IV). Përderisa mungesa e arsyeve të duhura në një rast të veçantë ose dështimi për të përfshirë viktimat nuk mund të thuhet se autoritetet kanë dështuar të hetojnë një çështje tërësisht, ajo mund të krijojë atë pamje për ata që janë të përfshirë aty. Prandaj, një zgjidhje efektive për qëllimet e nenit 13 duhet të kuptohet si zgjidhje që dukshëm është kujdesur për nevojën që të vendoset se rasti i paditësit ishte trajtuar në mënyrë të drejtë, me kujdes dhe në mënyrë efektive. Si është bërë kjo në praktikë është më mirë të lihet në rrethanat e veçanta të lëndës.
70. Në rastin konkret, ankuesit nuk duket se kanë qenë të informuar për rrjedhën e hetimeve në ndonjë fazë dhe se ishin informuar vetëm se ajo ishte ndërprerë atëherë kur ishte mbyllë hetimi. Ankuesit me sa duket nuk janë intervistuar nga autoritetet.

71. Shqetësimi i dytë i Panelit është se vendimet e prokurorëve të EULEX-it për të mbyllur rastet nuk janë arsyetuar, në kuptimin e ofrimit të udhëzimeve ankuesve lidhur me rezultatin e hetimit dhe arsyet për mbylljen e tij.
72. Përderisa detyra që i ngarkohet autoritetit gjyqësor për të ofruar arsyet nuk mund të imponohet në një masë të ngjashme tek një autoritet hetues ose prokurorial, mungesa e arsyes për mbylljen e hetimit mund të ngritë shqetësime nga pikëvështrimi i nenit 13 të Konventës. Së pari, një shpjegim për ndërprerjen e hetimit është qenësor në mënyrë që të sigurohet se vendimi i autoriteteve është ai që nuk ka qenë i bazuar në ndonjë shqyrtim, faktor apo supozim jo të duhur.
73. Për shkak se autoritetet nuk arritën të përfshijnë viktimat në mënyrë kuptimplote në proces dhe dështimi i tyre për t'u dhënë atyre arsye të qarta për ndërprerjen e hetimit rreth secilës prej të tria çështjeve të diskutuara më lartë (1989-5/2011; 3086-2/2011; 3985-8/2011), Paneli nuk është i bindur se elementi i nevojshëm i shqyrtimit publik ka qenë i përmbushur në lidhje me ndonjë prej këtyre tri rasteve. Në këto rrethana, Paneli konsideron se EULEX-i kanë shkelur të drejtat e ankuesve sipas nenit 13 të Konventës në lidhje me secilin dhe të gjitha prej këtyre tre ankesave të cekura, të parashtruara nga ankuesit.

*Shkeljet e pretenduara të nenit 14 të Konventës*

74. Paneli konsideron se duke pasur parasysh gjetjet, nenet 3, 8 dhe 13 të Konventës dhe arsyetimin që çojnë drejt tyre, ankesa në bazë të nenit 14 nuk ngritë ndonjë çështje të veçantë.
75. Paneli konstaton se nuk është e nevojshme për të shqyrtuar ankesat veç e veç në bazë të kësaj dispozite të Konventës.

**PËR KËTO ARSYE**

**PANELI, NJËZËRI**

1. *Shpall* ankesat sipas nenit 3 të Konventës të papranueshme pasi qartazi janë të pabazuara;
2. *Konstaton* se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës;
3. *Gjen* një shkelje të nenit 13 të Konventës;
4. *Konstaton* se nuk është e nevojshme për të shqyrtuar çështjen sipas nenit 14 të Konventës.

dhe

## DEKLARON

se në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, Paneli gjen të përshtatshme që të bëjë rekomandime për ShM-në, dhe

## REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME KORRIGJUESE

- a. ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë një shkelje të të drejtave të ankuesve që i ngarkohen veprimeve [dhe/ose mosveprimeve] të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv;
- b. ShM-ja duhet t'i ofroj një kopje të këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse. Kjo duhet të shërbej që të informohen prokurorët e EULEX-it rreth natyrës së përgjithshme të detyrimit të tyre për t'i përfshirë viktimat në hetimet e tyre dhe për të ofruar arsye të duhura rreth ndërprerjes së ndonjë hetimi në ndonjë rast të veçantë.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese